

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik – Universiteti i Prishtinës
Titulli i lëndës:	Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I – Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Kati i IV, Kabineti nr. 13
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Fatmir Sejdiu, Mr. Emine Abdyli, Mr. Xhafer Tahiri
Detajet kontaktuese:	Email: fatsej@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Lënda <i>“Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore”</i>, përfshinë shqyrtimet e përgjithshme lidhur me historinë e institucioneve juridike dhe shtetërore si dhe tri periudha kryesore të zhvillimit, periudhën skllavopronare, feudale dhe bashkëkohore. Në secilën prej këtyre periudhave do të flasim për vështirime të shkurtra historike, karakteristikat kryesore, rregullimin shtetërore, burimet e njohurive, për karakteristikat themelore të së drejtës, përfshirë të drejtën sendore, të drejtën e detyrimeve, të drejtën martesore dhe familjare, të drejtën trashëgimore, të drejtën penale dhe gjyqësinë dhe procedurat gjyqësore.</p> <p>Vendet të cilat do të jenë të fokus të kësaj lënde janë të gjitha ato vende që në vete ngërthejnë një zhvillim të dukshëm të institucioneve juridike dhe shtetërore në periudha të ndryshme kohore, siç janë: Egjipti, Babilonia, Athina, Sparta, Shteti i Frëngeve, Kalifati Arab, Bizanti, Franca, Perandoria Osmane, Anglia, SHBA, Franca, Gjermania, Austro – Hungaria dhe Rusia.</p>
Qëllimet e lëndës:	E gjithë materia e kësaj lënde, e cila prezantohet para studentëve, qoftë nëpërmjet ligjëratave apo ushtrimeve, seminareve dhe formave të tjera të punës me ta, ka për qëllim që studentët të pajisen me njohuri të përgjithshme të kulturës juridike, si dhe me elementet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e institucioneve juridike dhe shtetërore në përgjithësi, përgjatë etapave të ndryshme historike,

	<p>duke filluar nga periudhat më të hershme e deri në bashkëkohësi.</p> <p>Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore është lëndë bazike që shërben si mbështetje e rëndësishme për studimet e thelluara multidisiplinare, që janë pjesë e programit në Fakultetin Juridik. Po kështu, kjo lëndë ofron njohuri të rëndësishme sa i përket zhvillimit të shoqërisë njerëzore përgjatë mileniumeve.</p> <p>Moduli shërben si bazë e rëndësishme për t'u kompletuar si juristë dhe intelektualë të denjë në profesionin e tyre.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përvetësimit me sukses të kursit, studenti do të :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të aftësohen për historinë e përgjithshme të institucioneve juridike dhe shtetërore , • Të zotërojnë njohuri historike për krijimin dhe funksionimin e institucioneve juridike dhe shtetërore, • Të krijojnë njohuri historike prej celulave të para të shtetit e deri te shtetet e sotme bashkëkohore, • Të përvetësoj një pasqyrë të qartë lidhur me sistemin e së drejtës dhe funksionimin e saj prej periudhës skllavopronare e deri në ditët e sotme. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15
Kollokfiume,seminare	2	2/5	10
Detyra të shtëpisë	4	1/5	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	1/1	6
Projektet,prezentimet ,etj	14	1/1	14

Totali	6 ECTS	Total	180														
Metodologjia e mësimëdhënies:	Duke pasur parasysh numrin e madh të studentëve, si dhe fondin e orëve të paraparë në kuadër të programit të përgjithshëm mësimor në Fakultetin Juridik, do të aplikohet metoda e ligjërimit interaktiv. Për tematika të caktuara dhe me interes të veçantë, studentët do të angazhohen në përgatitje dhe prezantim të seminareve apo eseve të ndryshme dhe do të diskutohet rreth tyre. Orët e ushtrimeve sipas nevojës mbahen nga bashkëpunëtorët (asistentët) sipas orarit që parasheh fakulteti.																
Metodat e vlerësimit:	<p>Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet si vijon:</p> <p>10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime</p> <p>10% - Prezantimi gojor</p> <p>10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë)</p> <p>30% - Kollokiumi</p> <p>40% - Provimi final</p> <table border="1" data-bbox="716 1142 1385 1402"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi ne %</th> <th>Nota përfundimtare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>91-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>81-90</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71-80</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61-70</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51-60</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>0-50</td> <td>5 (pesë)</td> </tr> </tbody> </table>			Vlerësimi ne %	Nota përfundimtare	91-100	10 (dhjetë)	81-90	9 (nëntë)	71-80	8 (tetë)	61-70	7 (shtatë)	51-60	6 (gjashtë)	0-50	5 (pesë)
Vlerësimi ne %	Nota përfundimtare																
91-100	10 (dhjetë)																
81-90	9 (nëntë)																
71-80	8 (tetë)																
61-70	7 (shtatë)																
51-60	6 (gjashtë)																
0-50	5 (pesë)																
Literatura																	
Literatura bazë:	<p>Hilmi Ismaili - Fatmir Sejdiu: Historia e Institucioneve Juridike dhe Shtetërore, Prishtinë, 2009;</p> <p>Hilmi Ismaili - Fatmir Sejdiu : Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës, Prishtinë, 2000;</p> <p>H. Ismaili, Burime të zgjedhura juridiko-historike I, Prishtinë, 2001;</p>																
Literatura shtesë:	<p>A. Anastasi, Historia e institucioneve, Tiranë, 1998.</p> <p>Studentët mund të shfrytëzojnë edhe literaturë tjetër plotësuese, e cila lidhet më probleme të përgjithshme juridike - historike si edhe ato të historisë politike etj.</p>																
Plani i dizajnuar i mësimi:																	

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Shqyrtime të përgjithshme: Lënda, çështje të emërimit të lëndës; metodat e studimit, relacionet me shkencat tjera. Zhvillimi i historisë së institucioneve juridike dhe shtetërore si shkencë e veçantë. Njoftimin me programin, literaturën themelore dhe të përgjithshme si dhe me metodologjinë e punë.
Java e dytë:	Shkollat më të rëndësishme në zhvillimin e historisë të së drejtës: Shkolla e glosatorëve dhe Shkolla e postglosatorëve; Shkolla e juristëve elegantë; Shkolla e të drejtës natyrale; Shkolla historike e së drejtës dhe të ngjashme. Paraqitja e studentëve për tema të caktuara për punime seminarike apo ese.
Java e tretë:	Çështjet e periodizimit të historisë së institucioneve juridike dhe shtetërore. Burimet dhe monumentet juridiko-historike. Kritika dhe analiza e burimeve. Bisedë interaktive dhe përsëritje të leksioneve të mëparshme.
Java e katërt:	Shteti dhe e drejta në periudhën e skllavërisë. Krijimi i shteteve të para. Karakteristikat e përgjithshme të institucioneve juridike dhe shtetërore të kësaj periudhe. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme ose prezantimi i ndonjë punimi nga ana e studentëve.
Java e pestë:	Institucionet më të rëndësishme juridike dhe shtetërore në shtetet e Lindjes së Lashtë, e në veçanti në Egjipt dhe Babiloni. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme
Java e gjashtë:	Institucionet më të rëndësishme juridike dhe shtetërore në shtetet antike greke, me vështrim të veçantë në Institucionet juridike, shtetërore dhe politike në Athinën e lashtë. Prezentim i punimeve seminarike dhe diskutime rreth tyre.
Java e shtatë:	Institucionet më të rëndësishme juridike dhe shtetërore në periudhën e mesjetës, më saktë në feudalizëm. Institucionet juridike dhe shtetërore në shtetin e Frankëve.

Java e tetë:	Një vështrim i shkurtër i zhvillimit historik të institucioneve juridike dhe shtetërore në Kalifatin Arab. Institucionet juridike dhe shtetërore në Bizant. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentim i punimeve seminarike, si dhe diskutimi rreth tyre.
Java e nëntë:	Shqyrtim i veçantë i institucioneve juridike dhe shtetërore në Francën feudale që nga shekulli X e deri në shek. XVIII. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentim i punimeve seminarike, si dhe diskutimi rreth tyre.
Java e dhjetë:	Qytet – shtetet në feudalizëm. Përfshirë krijimin e qyteteve , shtresat shoqërore dhe pozita e tyre juridike, rregullimi shtetëror, organizatat kooperative. Gjithashtu, në këtë javë do të jetë në fokus edhe e drejta kanonike dhe burimet e saj të përgjithshme dhe të veçanta. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentim i punimeve seminarike, si dhe diskutimi rreth tyre.
Java e njëmbëdhjetë:	Institucionet juridike dhe shtetërore në Perandorinë Osmane. Vështrim i veçantë i të drejtës së shariatit dhe burimeve të saj. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme ose leximi dhe diskutimi rreth punimeve seminarike.
Java e dymbëdhjetë:	Institucionet juridike dhe shtetërore në periudhën e liberalizimit dhe atë bashkëkohëse: krijimi, periodizimi, karakteristikat e përgjithshme të së drejtës dhe burimet e së drejtës; shtetet më të rëndësishme të kësaj periudhe. Parimet themelore dhe karakteristikat e zhvillimit historik të së drejtës dhe shtetit liberal si dhe të shteteve bashkëkohëse. Zhvillimi i sistemeve juridike dhe degëve themelore të së drejtës në këtë periudhë. Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentim dhe diskutimi i punimeve seminarike.
Java e trembëdhjetë:	Institucionet juridike dhe shtetërore në Angli që nga shek. XII e deri te shek. XVII, rregullimin shtetëror të Anglisë, përfshirë mbretin, parlamentin, dhomën e epërme dhe të poshtme dhe kabinetin. Të drejtën në Angli, karakteristikat e përgjithshme dhe burimet e saj.

	<p>Kollokvium (testim i njohurive lidhur me materien e ligjëruar).</p> <p>Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentimi dhe diskutimi i punimeve seminarike.</p>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<p>Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kuadër të së cilës do të flasim për historikun e zhvillimit të SHBA-ve, për rregullimin shtetëror kushtetues, kongresin amerikan, presidenti i SHBA-ve, gjykata supreme amerikane, si dhe karakteristikat themelore të së drejtës në SHBA.</p> <p>Bisedë interaktive dhe përsëritje e leksioneve të mëparshme. Prezentimi dhe diskutimi i punimeve seminarike.</p>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<p>Shqyrtime të veçanta me sistemet juridike të kësaj periudhe edhe në Francë, në Gjermani, Austro-Hungari dhe në Rusi.</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.</p>	